

VENDIM
Nr. 56, datë 24.2.2000

PËR IMPORT-EKSPORTIN E BURIMEVE TË RREZATIMIT JONIZUES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 82, pika 3, të Kodit Doganor, të neneve 3 dhe 7, të ligjit nr. 8025, datë 9.11.1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Veprimet në pikat doganore për import-eksportin e burimeve të rrezatimit jonizues të kryhen vetëm pasi personat, juridikë apo fizikë, të kenë paraqitur dokumentacionin shtesë, si vijon:
 - Liçensën për veprimtari me burime të rrezatimit jonizues, të lëshuar nga komisioni i mbrojtjes nga rrezatimet, pranë Ministrisë së Shëndetësisë.
 - Lejen për import-eksportin e burimeve jonizuese, lëshuar nga zyra e mbrojtjes nga rrezatimet.
 2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për nxjerrjen e udhëzimit përkatës.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit të Fletores Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta